



Ky projekt është financuar nga Bashkimi Evropian

E - buletini no.14

Korrik 2017

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Aksioni për Zhvillim Rural (AZR) dhe në asnjë mënyrë nuk mund të merret parasysh për të pasqyruar mendimet e Bashkimit Evropian



Parlamenti Kombëtar Rural si Zëri i Banorëve Rural

'Kosta Veselinov' 3a,
1000 Skopje
R. Macedonia
T: +389 (2) 3075 506
F: +389 (2) 3075 503
email: info@ruralnet.mk
zg.akrra@yahoo.com

Organizatrat e implementimit





Hapje e projektit “Parlamenti Kombëtar Rural si zëri i popullatës rurale – PKR” financuar nga BE-ja

Fondacioni për Lidhje të Vlerave Natyrore dhe Njerëz në bashkëpunim me RZR i RM-së (Rrjeti për Zhvillim Rural i RM-së) dhe AZR (Aksioni për Zhvillim Rural), më 10 prill, në EU Info Qendrën kanë shënuar fillimin e projektit “*Parlamenti Kombëtar Rural si zëri i popullatës rurale – PKR*”.

Në bazë të nevojave dhe kufizimeve të identifikuar paraprakisht të organizatave qytetare nga fushat rurale, projekti ishte dizajnuar për të përforcuar ndikimin e shoqërisë qytetare mbi politikat lokale dhe kombëtare lidhur me zhvillimin rural. Kjo do të arrihet me anë të ngritjes së kapaciteteve të organizatave qytetare rurale për rrjetëzim dhe



përfaqësim për të ndikuar mbi proceset e vendimmarrjes dhe të kontribuojnë në partneritetin strategjik me autoritetet lokale dhe kombëtare.

Projekti PKR është projekt prej 30 muajve i financuar nga Bashkimi Evropian, dhe zbatuar nga tre organizatat partnere të theksuar më lartë.

Aktivitetet do të përfshijnë 40 organizata lokale të mjediseve rurale, mesatarisht nga 5 organizata qytetare në secilën prej 8 rajoneve të planifikimit të Maqedonisë, përfshirë edhe minoritete dhe grupe tjera etnike. Metoda kryesore e punës do të jetë trajnim, mësim dhe mësim praktik. Këto metoda do të nxisin organizatat qytetare të kyçen në mënyrë aktive në proceset e vendimmarrjes dhe do të përforcojnë zërin e tyre në shoqëri.

Përdoruesit përfundimtar të projektit janë banorët që jetojnë në mjediset rurale.

Në fund të periudhës së zbatimit, pritet që projekti të arrijë 4 rezultatet më poshtë:

- Rritja e transferimit të njohurisë mes organizatave qytetare rurale lidhur me sfidat e mjediseve rurale dhe vendimmarrjes;
- Ngritja e kapaciteteve të organizatave qytetare rurale (OQ) për udhëheqjen e proceseve për zhvillim rural;
- Shkathtësi të zhvilluar për humlumtim dhe analizë të OQ-ve rurale;
- Dialog i lehtësuar efektiv mes OQ-ve rurale dhe pushtetit lokal/kombëtar.



Organizatrat qytetare do të punojnë bashkë për të përmirësuar politikatat e zhvillimit rural

Gjatë muajit maj dhe qershor 2017, projekti „*Parlamenti Kombëtar Rural si zëri i popullatës rurale – PKR*“, ka organizuar 7 prej gjithsej 8 takimeve me organizatat qytetare në rajonin e planifikimit juglindor, lindor, jugperëndimor, veriperëndimor, Pellagonisë, Vardarit dhe Pollogut për t'i nxitur që të diskutojnë për mundësinë e kyçjes së tyre më të madhe në krijimin e politikave të lidhur me zhvillimin rural, si dhe të identifikojë organizata që punojnë në mënyrë aktive në fushën e zhvillimit rural. Rreth 130 përfaqësues të organizatave qytetare kanë marrë

pjesë në takimet të organizuar në: Pehçevë, Strumicë, Strugë, Tetovë, Manastir, Kumanovë dhe Negotinë.

Projekti ka organizuar këto takime me organizatat qytetare për të prezantuar aktivitetet e planifikuara dhe të nxit pjesëmarrje me aktive të organizatave në procesin e ngritjes së kapaciteteve për rrjetëzim dhe përfaqësim. Në këtë mënyrë, projekti synon të përforcojë ndikimin e shoqërisë qytetare me anë të kyçjes në krijimin e politikave publike, dialog qytetar dhe proceset e marrjes së vendimeve për përmirësim të kushteve për jetë në mjediset rurale.





Takimet me organizatat qytetare në 8 rajonet e planifikimit të Republikës së Maqedonisë do të përdoren si bazë të regjistrit të organizatave aktive qytetare që punojnë në fushën e zhvillimit rural. Në sajë të këtij aktiviteti, projekti do të zbatohet hulumtim në teren me qëllim të identifikojë sa më shumë që mundet orga-

nizata qytetare rurale që punojnë në tema lidhur me zhvillimin rural.

Projekti “Parlamenti Kombëtar Rural si zëri i popullatës rurale”, i financuar nga **Bashkimi Evropian**, ka filluar të zbatohet në mars 2017 nga ana e tre organizatave partnere: **Fondacioni për Lidhje të Vlerave Natyrore dhe Njerëz (CNVP)**, **Rrjeti**



për Zhvillim Rural i RM-së (RZR i RM) dhe Aksioni për Zhvillim Rural (AZR). Aktivitetet e projektit parashikohet të përfshijnë 40 organizata lokale të mjediseve rurale, mesatarisht 5 organizata qytetare në secilin prej 8 rajoneve të planifikimit të Maqedonisë, përfshirë edhe minoritete dhe grupe etnike. Metoda kryesore e punës do të jetë trajnim, mësim dhe mësim praktik, me çfarë do të nxiten organizatat qytetare rurale për aktivitete më të mëdha në proceset e marrjes së vendimeve dhe krijimit të partneriteteve strategjike me autoritetet lokale dhe kombëtare.



MIKRO – rritja e konkurrencës së mikro-ndërmarrjeve në mjediset rurale



Shoqata Instituti për Zhvillimin e Komunitetit – Maqedoni, në sajë të aktiviteteve për mbështetje dhe zhvillim të ndërmarrjeve nga mjediset rurale në Republikën e Maqedonisë, në bashkëpunim me partnerët nga Irlanda, Spanja, Greqia dhe Italia, punon në zbatimin e projektit “MIKRO – rritja e konkurrencës së mikro-ndërmarrjeve në mjedise rurale”. Projekti është mbështetura nga Programi Erasmus + të Bashkimit Evropian.

Projekti MIKRO, me anë të qasjes inovative, nxit zhvillimin e shkathëtisë themelore dhe transversale siç janë sipërmarrja, aftësia për funksionim në tregun e brendshëm të BE-së dhe vetë-punësim. Metoda inovative e MIKRO mbështetet në qasjen “nga poshtë lartë” i nxitur nga kërkesa dhe duke konsoliduar ekspertizën nga praktikantë të arsimit profesional dhe trajnimit, si dhe ekspertë të fushës përkatëse.

Metoda inovative gjithashtu mbështetet në qasjen e hapur të

shfrytëzimit të rezultateve, ashtu që MIKRO bëhet një platformë jo vetëm për trajnim dhe ngritjen e kapaciteteve, por edhe për rrjetëzim, lehtësim të shkëmbimit dhe bashkëpunimit ndërkufitar dhe identifikim të partnerëve për mikro-ndërmarrjet rurale nga vendet anëtare të BE-së.

Gjatë zbatimit, MIKRO e mbështet zhvillimin e zgjidhjeve cilësore të larta të orientuar për punë në fushën e arsimit profesional që do të mund të zbatohen në mikro-ndërmarrjet ekzistuese me qëllim të përforcimit të konkurrencës së tyre.

Më tepër informacione në lidhje me projektin mund të gjeni në internet faqen më poshtë://www.microsmetraining.eu





Veprimet e Koalicionit Rural – Kumanovë në sektorin qytetar

► **Realizim dhe finalizim të suksesshëm të projektit “Ekonomia e tregut dhe kapacitete institucionale”,** ishte shënuar me zhvillimin e prezantimit të rezultateve të arritura në projektin dhe ka shkaktuar përfaqësim të gjerë mediatik. Ishin zhvilluar 5 debate publike në 5 rajone të planifikimit dhe 5 qytete të territorit të vendit (Kumanovë, Strumicë, Gostivar, Strugë dhe Prilep) në të cilat në një tavolinë të përbashkët institucionet dhe fermerët i kanë shqyrtuar relacionet e tyre, kapacitetet, efikasitetin dhe efektivitetin në punën e institucioneve edhe furnizimit të shërbimeve, si dhe nivelin e dy palëve të ndikojnë mbi formimin e relacioneve në ekonomi të tregut. Përveç kësaj ishte bërë edhe një analizë e hollësishme e punës së 5 institucioneve kyçe në sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural (Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së ujit, Agjencia për Mbështetje Financiare të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia për Nxitjen e Zhvillimit të Bujqësisë, Agjencia për Ushqim dhe Veterinë, Inspektorati Shtetëror Bujqësor) në aspekt të furnizimit të shërbimeve, efikasitetit, efektivitetit, transparencës, gatishmërisë për qytetarët dhe bashkë-relacion me



numrin e të punësuarve në secilin institucion dhe buxheti vjetor ose mjete me të cilat disponon institucioni për punë operative; publikohet analizë me rekomandime për institucionet që dalin direkt nga fermerët për përmirësim të punës së tyre që ishte rezultati përfundimtar i projektit. Analiza ishte dorëzuar tek institucionet dhe e njëjta mund të gjendet në formë elektronike në lidhjen vijuese: <http://rural.mk/proekti/realizirani/pazarna-ekonomija-i-institucionalni-kapaciteti/> Vlera e shtuar e projektit ishte përpunimi i një harte të institucioneve që do të jetë në dobi të fermerëve dhe në çdo kohë të mund të identifikojnë kompetencat e institucioneve përkasë që mos të shëtiten prej sporteli në sportel nëse kanë nevojë të realizojnë ndonjë të drejtë ose obligim. Projekti ishte mbështetura financiarisht nga Fondacioni Shoqëri e Hapur Maqedoni.

► **Promovim i broshurës “Ligjet janë në vend, zbatimi mungon - Ligji për Bujqësi dhe Zhvillim Rural - bazë për zhvillimin e bujqësisë konkurruese”** që në vete përmban analizën e Ligjit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural duke vendosur theksin në ato dispozita ligjore që më tepër i prekin fermerët dhe prej të cilëve do të nxjerrin të drejtat dhe obligimet e tyre, dhe me qëllim të njëjta të jenë më mirë të njohura për të mundur të referohen çdoherë kur të paraqitet nevoja për atë në komunikimin e tyre me institucionet ose në pjesën e rregullimit të relacioneve të tyre me blerësit dhe konsumatorët e fundit. Broshura ishte produkti i fundit i aktiviteteve 8 mujore të Koalicionit Rural te cilat i ka realizuar në sajë të projektit “Ligjet janë në vend, zbatimi mungon” dhe që ishte financiarisht i mbështetur nga projekti IPA 2 Mekanizmi për Organizata Qytetare të zbatuar nga EVROTNİK, Eko-Svest, Reaktor





dhe Zenit në procesin e nën-grantimit, dhe në kuadër të IPA Programit për Organizata Qytetare dhe medie 2014. Broshura me drejtime të zhvilluara për zbatimin e përmirësuar të Ligjit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, duke përfshirë edhe hulumtimin në tere për njohjen e ligjit nga fermerët mund të gjendet në lidhjen vijuese: <http://rural.mk/proekti/realizirani/zakomite-gi-ima-primenata-ja-nema/>

► Koalicioni Rural me sukses ka përfunduar procesin e krijimit të strategjisë për zhvillim organizativ për periudhën 2018-2020, që ka përfshirë edhe revizion të vizionit të deritanishëm, misionit, dhe mënyrës së veprimit të organizatës. Procesi ishte i përfshirë dhe ka filluar në shkurt 2016 me identifikimin e nevojave për organizatën dhe grupet e synimit dhe pastaj të kalojë në një proces më vëllimor të screening të kapaciteteve të Koalicionit si rrjet, kapacitetet e organizatave-anëtare të Koalicionit, si dhe analiza e resurseve njerëzore dhe teknike me të cilat disponojnë si Koalicion, si dhe anëtarët e saj. Procesi ishte mentoruar



nga ekspertiza vendore dhe e huaj në fushën, dhe me mbështetje të plotë teknike dhe logjistike të TAKSO zyrës në Maqedoni dhe i njëjti ka mbaruar këtë qershor të këtij viti dhe ka përfshirë 2 punëtorë me ekspert të huaj në pjesën e rrjeteve dhe koalicioneve, pastaj formim të grupeve të punës për përgatitjen e pjesëve të ndryshme të strategjike

me mentor vendas, gjatë së cilës ishte zhvilluar punëtorë treditëshe dhe 3 takime pune të grupeve që drejtpërdrejt kanë marrë pjesë në përpunimin e dokumentit strategjik. Ishte parashikuar që strategjia të miratohet në Kuvendin Vjetor të Koalicionit në shtator-tetor të këtij viti dhe të fillohet me zbatimin nga viti 2018.





Edukimi i prodhuesve individual bujqësor për përdorimin e materialit standard të farave dhe mbjellës

Shoqata e prodhuesve të llojeve kopshtare dhe luleve “Horti Eko” nga f. Dobrejci, rrethina e Strumicës ka filluar me zbatimin e projektit “Edukimi i prodhuesve individual bujqësor për përdorimin e materialit standard të farave dhe mbjellës”, që është financiarisht i mbështetur nga komuna e Strumicës. Në bashkëpunim me ndërmarrjen komunale Komunalec nga Strumica, ishin

zbukuruar disa pjesë të Strumicës me material mbjellës nga llojet e luleve: Pelargonium zonale, Begonija semmerwingse daerk elegance, Calibrachoa superbells double ruby, Surfinia table dark red. Në projektin janë të përfshirë të rinj nga mjedise të rajonit të Strumicës që kanë mundësi të mësojnë më tepër teknika për mbjellje dhe kultivim të materialit të standardizuar të farave dhe mbjellje. Ishin përfshirë edhe



nxënësit e drejtimit “hortikulturë” të SHMK “Dimitar Vllahov”, Strumicë, që kanë pasur mundësi të përfitojnë përvojë praktike nën udhëheqjen e disa profesorëve dhe Ndërmarrja Komunale Komunalec të Strumicës. Një prej qëllimeve të aktiviteteve është të rritet vetëdija tek të rinjtë mbi prodhimtarinë dhe përdorimin e materialit të standardizuar të farave dhe mbjelljes.





Vizitë e festivalit Zllaten Grozd në Mellnik

Në organizim të shoqatës “Horti Eko” nga Strumica më 12 shkurt 2017, 55 fermerë të rajonit të Strumicës kanë vizituar festivalin Zllaten Grozd në Mellnik, R. e Bullgarisë. Të pranishmit në manifestimin kanë pasur mundësi të degustojnë lloje të ndryshme të verërave nga lloje vendore të rrushit, të prodhuar me receta të vjetra tradicionale, siç është e njohura vera Mellnik nga loji “Rrushi i gjerë i Mellnikut”.

Festivali ka gjallëruar qytetin në të cilin kanë arritur qindra mysafirë nga vendi dhe jashtë vendit për të provuar eliksirin e kuq dhe të kënaqen në magjinë e piramidave prej rëre. Qëllimi i këtij festivali është afirmimi i verës si produkt kombëtar dhe zhvillimi i rajonit si pikë për turizëm të verës, që do të kontribuojë për ruajtjen e traditës dhe përmirësimin të kushteve të jetës rurale.



Në Selanik zhvillohet Panairi i 10-të Ndërkombëtar për Blegtori dhe Shpendari – Zootehnia 2017

Një grup prej 75v fermerëve të Maqedonisë në organizim të shoqatës “Horti Eko” nga f. Dobrejci, rrethina e Strumicës, më 04.02.2017 kanë marrë pjesë në Panairin e 10-të Ndërkombëtar për Blegtori dhe Shpendari – Zootehnia 2017, në Selanik, Greqi. Në panairin fermerët

kanë pasur mundësi të njoftohen me teknologjitë e reja që përdoren në sektorin e blegtorisë dhe ishin prezantuar edhe arritjet më të reja në pjesën e mekanizimit bujqësor, pajisje dhe repro-materiale. Qëllimi i vizitës së panairit qëllimi i vizitës së panairit ishin të shkëmbehen përvo-

ja dhe ide, të demonstron zbatimin praktik të teknikave dhe teknologjive në bujqësi, të zgjerohet dhe nxitet zbatimi i tyre tek ne, të realizohet bashkëpunim dhe partneritet, si dhe të kopjohen mënyra inovative të prodhimit.





Aktivitete të realizuar nga GLA Skardus



Gjatë periudhës së kaluar GLA Skardus me sukses ka realizuar projektin “Tharëse Diellore”. Qëllimi i projektit është përdorimi i qëndrueshëm dhe i dobishëm i resurseve natyrore me anë të përdorimit të energjisë diellore. Në sajë të projektit është siguruar një tharëse diellore për tharje të pemëve, perimeve, bimëve shëruese dhe çaje me kapacitet prej 120 kg. Projektin është mbështetur nga AIRE dhe Ambasada e Zvicrës.

Më 23 mars 2017, në zyrat e komunës së Jegunovcës, si pjesë e konferencës përfundimtare të projektit



“Zgjerimi i bizneseve të vogla” ishte zhvilluar promovim i tharësës dhe trajnim mbi përdorimin. Ngjarja ishte mbuluar nga dy medie lokale. Më tepër për ngjarjen mund të shikoni në:

<https://youtu.be/K9wCd3TjDQg>
<https://www.youtube.com/watch?v=YTgXEY38PE8>

GLA Skardus ka zhvilluar Kuvendin e Parë më 25 maj 2017 në zyrat e komunës së Jegunovcës. Në Kuvend kanë marrë pjesë anëtarët e GLA-së dhe mbështetës tjerë të interesuar të GLA-së.

Për momentin realizohet projekti “Energji e ripërtëritë – produkt ekologjik”. Qëllimi i idesë së projektit është drejtimi i qëndrueshëm dhe i dobishëm me resurse natyrore me anë të përdorimit të energjisë së ripërtëritë. Projektin është mbështetur nga AIRE dhe Ambasada e Zvicrës. Afati i zgjatjes së projektit është nga korriku deri më shtator të vitit 2017.

Më tepër për punën e GLA Skardus mund të lexoni në <https://www.facebook.com/lagskardus/>
<http://leaderjt.simplesite.com/>





Ekipi i CeProSARD me sukses ka realizuar projektin Polog Energy Net

Si pjesë e aktiviteteve që zbaton CeProSARD me Qendrën për Zhvillim të Rajonit të Planifikimit të Pollogut dhe në sajë të projektit Polog Energy Net më 26.05.2017 në Gostivar ishte zhvilluar ngjarje përfundimtare për rëndësinë dhe nevojën e drejtimin të integruar të energjisë në Rajonin e Planifikimit të Pollogut.

Në ngjarjen ishin prezantuar shembuj praktik për efikasitet energjetik të përfshirë në Udhëzuesin për Drejtimin e Integruar të Energjisë. Pjesëmarrësit e interesuar kanë pasur mundësinë të vizitojnë laboratorin lëvizës “Eko-Karavan”. Para pjesëmarrësve të ngjarjes dhe përfaqësuesve të Rrjetit Rajonal për Drejtimin e Integruar të Energjisë (RRDIE), zonja Nertila Dika ka promovuar rëndësinë e përdorimit të burimeve të ripërtëritë të energjisë dhe zbatimi i efikasitetit energjetik.

Projekti Polog Energy Net ishte zbatuar në sajë të projektit “Orga-



nizata të Përforuara Qytetare për transponim pjesëmarrës dhe zbatim të pakos BE 2020 për energji dhe klimë” i financuar nga Bashkimi Evropian, si nën-grant i Milieukontakt Maqedoni, Front dhe Institutit për Trajnim KOCKA.

<https://www.youtube.com/watch?v=X2WwdrdMrXQ>

<http://www.ceprosard.org.mk/MK/Aktuelnosti/info.aspx?cid=334>





Pazar Ballkanik të veprave vendore artizane

Në organizim të Shoqatës së Artizanëve ARTI KRAFT – Shkup dhe komuna e Çairit, prej 3 deri 6 maj 2017, në sheshin Skënderbeu në Shkup, u zhvilluar Pazar Ballkanik i veprave vendore artizane. Shumë stenda ishin stolitur me veprat artizane të vendit dhe rajonit, duke tërhequr shumë vizitorë.



Në kuadër të programit, më 5 maj ishte organizuar një revial i modës me titullin “Etno Trend”, në të cilën kamë marrë pjesë anëtarë të studios së modës Etno Beba nga Kumanova. Nga formimi i saj në vitin 2001 deri më sot, Etno Beba është rritur në lider për përpunimin e veshjeve bashkëkohore të inspiruar nga tradita dhe folklori maqedonas.

“Duke shikuar nevojën e ruajtjes së shenjave kulturore në Kumanovë,

me vetë formimin dhe përvojën, Etno Beba ka nisur rrugën drejt të mësuarit, përpunimit dhe prezantimit të veprave artizane kreative dhe suvenire, që me llojllojshmërinë e tyre e pasqyrojnë kulturën tonë, zakonet, dhe kanë traditë të gjatë në hapësirat tona” – theksoi Gordana Mitrovska Beba.

Në ngjarjen ishte prezantuar edhe një koleksion i titulluar “Nota të Arta” të Dragana Stojkoviq nga Uzhice.



Komiteti Kombëtar për Bujqësi Familjare (KKBF)



IZB Tetovë në kuadër të aktiviteteve të programit në partneritet me Rrjetin për Zhvillim Rural të RM-së dhe Federatës së Fermerëve të RM-së kanë zbatuar projektin për themelimin e Komitetit Kombëtar për Bujqësi Familjare. Projekti është mbështetur nga Forumi Botëror Rural dhe Civica Mobilitas.

Në sajë të projektit është zhvilluar edhe punëtori për Strukturë të Brendshme të KKBF në Hotel

Romantik – Veles prej 14-16 mars 2017. Pjesëmarrësit në punëtorinë kanë punuar në dy tema “Vendosja organizative dhe kanale të komunikimit” dhe “Specifikime të bujqësisë familjare dhe roli”. Rezultatet e punëtorisë janë ndarë me pjesëmarrësit e punëtorisë dhe të miratuar nga Kuvendi i parë i KKBF.

Nga ana e RZR e RM-së ishte zbatuar një hulumtim për gjendjen e bujqësisë familjare në RM. Rezultatet e hulumtimit ishin prezantuar gjatë



NCCFFM

Komiteti Kombëtar për Bujqësi Familjare (KKBF) i Republikës së Maqedonisë, në sajë të aktiviteteve programore, gjatë muajit shtator 2017 do të organizojë 4 trajnime me qëllim të përforcimit të kapaciteteve të personave dhe shoqatave/organizatave që janë drejtë të përfshirë në punën e ekonomike bujqësore familjare ose i ndihmojnë këto familje. Më tepër informacione në internet faqen vijuese:

www.ncffm.mk/aplikacija

Kuvendit të parë të KKBF.

Në periudhën prej 25-26 maj 2017 në Shkup, FFRM ka organizuar një punëtori për planifikim strategjik në të cilën ishin përpiluar SWOT dhe PEST analiza dhe ishin përcaktuar qëllimet strategjike të Komitetit.

Plani strategjik ishte miratuar në Kuvendin e parë të Komitetit që u zhvillua më 29 qershor 2017 në Fakultetin për Shkenca Bujqësore dhe Ushqim. Në këtë rast ishte nënshkruar edhe një deklaratë për themelimin e KKBF.

Gjatë muajit të shtatorit në kuadër të projektit do të zhvillohen 4 punëtori dyditore në të cilat të gjitha palët e interesuar do të mundës paraqiten me plotësim të aplikacionit në internet faqene KKBF.

Më tepër informacione mbi projektin mund të gjeni në

www.ncffm.mk





Skopje Travel Market 2017



Panairi i shtatë ndërkombëtar për turizëm **SKOPJE TRAVEL MARKET 2017** ishte organizuar nga Panairi i Shkupit në partneritet me Odën Ekonomike për Turizëm të RM-së dhe Rrjetit për Zhvillim Rural të Republikës së Maqedonisë, dhe ishte zhvilluar gjatë periudhës prej 6 deri 8 prill 2017.

Në panairin në të cilin kanë marrë pjesë agjenci turistike dhe opera-

torë turistik, hotele nga Maqedonia, kompani për prodhimtari të pajisjes për hotele, kanë pasur mundësinë të prezantohen një pjesë e Grupeve Lokale të Aksionit si dhe anëtarët e Rrjetit që punojnë në ruajtjen dhe promovimin e artizanëve tradicional. Pjesëmarrësit kanë shfrytëzuar ngjarjen për promovim të rajoneve të tyre para vizitorëve dhe për realizim të takimeve, kontakteve dhe partneriteteve me përfaqësues të sektorit afarist dhe vetëqeverisjen lokale.



Pjesëmarrja e aktorëve në panairin ishte mbështetur financiarisht nga projekti ALTER – *Territore Lokale Aktive për Zhvillim Ekonomik të Mjediseve Rurale*, që kanë pasur për qëllim të përforcojnë kapacitetin e organizatave qytetare që kontribuojnë për zhvillimin e qëndrueshëm social-ekonomik të mjediseve rurale në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi, për të marrë pjesë aktive në krijimin dhe zbatimin e politikave, të ndërtojë shoqëri të fuqishme qytetare në mjediset rurale dhe të rrit zhvillimin rajonal me anë të rrjetëzimit dhe bashkëpunimit.





Zhvillohet punëtorja për përgatitje të strategjisë dhe planit të veprimit të RZRB

Prej 15 deri 17 maj 2017, në Shkup, ishte organizuar punëtori për hartimin e strategjisë 5 vjeçare të Rrjetit për Zhvillim Rural të Ballkanit dhe planin e veprimit për 2 vitet. Përfaqësuesit e rrjeteve për zhvillim rural të Serbisë, Malit të Zi, Bosnjës dhe Hercegovinës, Kroacisë, Shqipërisë dhe, Kosovës dhe Maqedonisë, si anëtare të RZRB, kanë punuar bashkërisht për të zhvilluar dokument strategjik dhe të parashikojnë aktivitetet e nevojshme për arritjen e prioriteteve strategjike. Punëtorja ishte e mbështetur nga We Effect si pjesë e aktiviteteve që zbaton Rrjeti për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë në kuadër të projektit “Mbështetje e Rrjetit për Zhvillim Rural të Ballkanit – RZRB si platformë funksionale rajonale për bashkëpunim të rrjeteve rurale”. Aktivitetet e projektit përqendrohen në ngritjen e kapaciteteve të Rrjetit për Zhvillim Rural të Ballkanit (RZRB) me qëllim që të rritet aftësia e organizatave



anëtare, që luajnë rol të rëndësishëm në zhvillimin e qëndrueshëm social-ekonomik, të bashkëpunojnë me qeveritë dhe të ndikojnë mbi politikën dhe proceset e vendimmarrjes në mjediset rurale. Aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve të RZRB kanë të bëjnë me drejtimin e brendshëm, administrimin financiar dhe drejti-


min me projekte, planifikimi afatgjatë, llojllojshmëria e financimit dhe rrjetëzimi. Një përqendrim i fuqishëm i projektit është vendosur në mbështetjen e grave rurale në procesin e ngritjes së kapaciteteve dhe rrjetëzimit të brendshëm, si bazë për uljen e ndikimit negativ të mungesave që paraqiten në mjediset rurale.





Seanca e 38-të e Asamblesë së GPP dhe takimi i Rrjeteve të Zhvillimit Rural nga Evropa Juglindore

Rrjetet e Zhvillimit Rural të Republikës së Maqedonisë, Serbisë, Malit të Zi, Bosnjë dhe Hercegovinë, Shqipëri dhe Kosovë, si anëtarë të Rrjetit për Zhvillim Rural të Ballkanit ishin të ftuar nga Grupi i Përhershëm Rajonal për Zhvillim Rural në Evropën Juglindore – GPP për të marrë pjesë në seancën e 38-të të Asamblesë, e zhvilluar në periudhën **9-12 prill në Ljublanë, Slloveni**. Asambleja ishte organizuar me mbështetjen e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ushqimit e Sllovenisë.



Gjatë Asamblesë, anëtarët e RZRB kanë pasur mundësinë të prezantojnë rrjete e tyre dhe Rrjetin e Zhvillimit Rural të Ballkanit para delegatëve të GPP. Në sajë të ngjarjes, RZRB ka pasur takimin e saj në të cilin ishin diskutuar aktivitetet aktuale dhe të planifikuara. Përfaqësuesit e Rrjetit për Zhvillim Rural

të Republikës së Maqedonisë kanë prezantuar projektin “Mbështetje të Rrjetit për Zhvillim Rural të Ballkanit – RZRB si platformë funksionale rajonale për bashkëpunim të rrjeteve rurale të Ballkanit Perëndimor” të financuar nga We Effect dhe kanë paralajmëruar punëtorinë e planifikimit strategjik.



LEADER / CLLD mbledhja: “Roli i qasjes “nga poshtë lartë” për rinovim të Fondeve Strukturore dhe Investuese Evropiane për 2021-2027”



Maqedoni për njohje më të madhe dhe praktika dhe mbështetje të zhvillimit të kapaciteteve për zbatimin e qasjes LEADER.

Rreth 50 pjesëmarrës kanë marrë pjesë në mbledhjen, duke prezantuar Grupe Lokale të Aksionit (GLA) dhe rrjete LEADER, anëtarë të Parlamentit Evropian, Komisionit Evropian, Rrjetit Evropian për Zhvillim Rural, bashkëpunëtorë në gjithë Evropën, etj.



Rrjeti për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë, si anëtare e ALEZR – Asociacioni i Liderëve Evropian për Zhvillim Rural, ka marrë pjesë në mbledhjen LEADER / CLLD: “Roli i qasjes nga poshtë lartë për rinovimin e Fondeve SIE për 2021-2027” që u zhvillua më 31 maj në Bruksel.

Tema kryesore e mbledhjes ishte ri-

novimi i politikës për zhvillim rural për periudhën e programimit prej 2021-2027 ndërsa panel diskutimi ishte fokusuar në përf forcimin qasjes “nga poshtë lartë” dhe pjesëmarrja në nivelin lokal. Mbledhja ishte një mundësi e shkëlqyeshme për përfaqësuesin e RZR të mësojë nga përvoja e vendeve evropiane për zbatimin e LEADER dhe CLLD si dhe të adresojë nevojën e aktorëve rural në



Organizatorë:



LEADER
ESTONIA



REPUBLIC OF ESTONIA
MINISTRY OF RURAL AFFAIRS



Co-funded by the
Europe for Citizens Programme
of the European Union



Under the auspices of
the Secretary General of
the Council of Europe,
Mr Theodorin Jagland

